

UNIVERSITETI I PRISHTINËS
“HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI I EDUKIMIT FIZIK DHE SPORTIT



PUNIM DIPLOME MASTER

**PREFERENCAT E MARRJES ME AKTIVITETE REKREATIVE
DHE SPORTIVE SI DHE SHPREHITË INDIVIDUALE TEK
NXËNËSIT E KOMUNËS SË PODUJEVËS**

Mentori:
Prof. Dr. Bujar Turjaka

Kandidati:
Genc Sinani

Prishtinë, 2018

PËRMBAJTJA

1	HYRJE.....	3
1.1	HULUMTIMET E DERITANISHME	4
2	QËLLIMI I PUNIMIT	8
3	HIPOTEZAT THEMELORE	9
4	METODAT E PUNËS	10
4.1	MOSTRA E ENTITETEVE	11
4.2	MOSTRA E VARIABLAVE	11
4.2.1	Variablat e aplikuara.....	11
5	METODAT PËR PËRPUNIMIN E TË DHËNAVE	14
6	REZULTATET DHE DISKUTIMI	15
6.1	Frekuencat dhe përqindjet e përgjigjeve të femrave 15-16 vjeçare	15
6.2	Frekuencat dhe përqindjet e përgjigjeve të femrave 17-18 vjeçare	23
6.3	Frekuencat dhe përqindjet e përgjigjeve të meshkujve 15-16 vjeçarë	32
6.4	Frekuencat dhe përqindjet e përgjigjeve të meshkujve 17-18 vjeçarë	40
6.5	DALLIMET NDËRMJET TË GJITHA GRUPEVE NË NDRYSHORET E AKTIVITETIT FIZIK	49
7	HIPOTEZAT THEMELORE	56
8	PËRFUNDIMI.....	57
9	LITERATURA	59

1 HYRJJE

Aktiviteti fizik ka shumë efekte përfituese në drejtim të shëndetit, pavarësisht nga moshën. Njerëzit të cilët bëjnë një jetë të shëndetshme dhe që rregullisht përfshihen në ushtrime, kanë më pak mundësi të zhvillojnë sëmundje kronike, duke përmendur këtu diabetin jo insulin-vartës, sëmundjet kardio-vaskulare, sëmundjet tumorale, ose sëmundjet mendore. Gjithashtu, personat me aktivitet fizik ditor permanent mund të mbajnë peshën e tyre trupore në normat e lejuara po të krahasohen me personat që janë më pak aktiv. Mënyra aktuale e jetesës kërkon aktivitet më të pakët fizik si pasojë e rritjes së përdorimit të makinave, shikimit të televizorit dhe aktivitetit të pakët fizik në shtëpi, për shkak të modernizimit të aparaturave elektronike. Kësaj i shtohen edhe zakone të tjera të mënyrës së jetesës (si pirja e duhanit), shtimi i peshës, të cilat kontribuojnë në rritjen e rrezikut ndaj sëmundjeve kronike. Rekomandohen ushtrimet e përditshme, ecja, vrapimi, kërcimi, noti etj. Njerëzit të cilët kanë futur në rutinën e mënyrës së tyre të jetesës skemën e ushtrimeve, kanë përmirësime të mirëqenies së tyre fiziologjike dhe psikologjike.

Aktiviteti fizik si një fenomen social ndikon pozitivisht në zhvillimin aftësive dhe veçorive antropologjike të njeriut. Përmbajtja e aktivitetit fizik (lloji i ushtrimeve si dhe intenziteti dhe ekstenziteti i ekzekutimit) ndikojnë në ruajtjen dhe avansimin e shëndetit të të gjitha moshat, e sidomos të personat me gjendje më të mirë ekonomike dhe sociale. Rekreacioni sportiv është aktivitet i lire dhe i organizuar i cili njeriut i mundëson ripërtëritje fizike dhe psikike dhe ndihmon në riaftësim për të gjitha fushat e aktiviteteve jetësore me të cilat merret individi gjatë jetës si dhe në ruajtjen dhe vendosjen edhe të raporteve të shëndosha shoqërore.

Rekreacioni sportive është fushë specifike e kulturës, që i kënaq nevojat dhe interesat kryesore të njeriut përmes aktiviteteve reaktive - sportive, që i përmbush nevojat dhe interesat e të gjitha moshave gjinive dhe kategorive të ndryshme me aftësi dhe gjendje të ndryshme shëndetësore.

Rekreacioni është aktivitet i tërësishëm i njeriut jashtë punës profesionale që ai vetë e zgjedhë sipas përcaktimit personal me orientim drejt aspiratave pozitive.

Rekreacioni i kontribuon zhvillimit të personalitetit, kënaqjes së nevojave, interesave për krijimtari, ngritjes së gjendjes së mirë emocionale dhe shkathtësive psikike.

Koha e lirë sot e në të ardhmen paraqet sferën vendimtare e cila njeriu i mundëson që ai të jetoj jetën e vet, e jo vetëm të mbijetojë duke punuar.

Rekreacioni paraqet shprehjen spontane të dëshirës së njeriut për ti plotësuar nevojat dhe interesat e veta duke u orientuar në aktivitete të zgjedhura sipas dëshirës së vetë me qëllim freskimi, pushimi, zbavitjeje dhe shfrytëzimi sa ma racional të kohës jashtë obligimeve të punës gjatë kohës së lirë.

1.1 HULUMTIMET E DERITANISHME

Në hulumtimin dhe studimin e literaturës që kemi pasur në dispozicion, në mes tjerash duhet të përmendim këto hulumtime:

Burns RD, Fu Y, Hannon JC, Brusseau TA- në një hulumtim të publikuar ne **PUBMED** Në shqyrtimin e efektit të një programi gjithëpërfshirës të aktivitetit fizik në shkollë (CSPAP) mbi aftësitë motorike të fëmijët ku u përfishin 959 fëmijë nga 5 shkolla. Të dhënat u grumbulluan në fillim të vitit shkollor dhe në fund të 36 javorit të hulumtimit. Aftësitë motorike u vlerësuan duke përdorur testin për zhvillimin e brendshëm të aftësive motorike duke u bazuar në moshën dhe gjininë si modifikues të efektit dhe duke përshtatur për grumbullimin e vëzhgimeve brenda strukturës së të dhënave. Fëmijët treguan rezultate të përmirësuara të aftësisë motorike bruto në fund të 36 javorit hulumtues.

Cale, L. (2007) ka hulumtuar vlerësimin e aktivitetit fizik te adoleshentet. Qëllimi i punimit ka qenë vlerësimi i nivelit të aktivitetit fizik të 103 vajzave të moshës 11-14 vjeçare. Është përdorë pyetësori intervistë i cili ka përfshi katër ditë të aktivitetit ku kanë hyrë dy ditë pune dhe dy ditët e fundjavës e shtuna dhe e diela përgjatë gjashtë muajve. Niveli i aktivitetit fizik i vajzave në përgjithësi ka qenë i ulët. Afërsisht 45% e tyre kanë qenë të angazhuara në aktivitete jo vigoroze derisa shumica dërrmuese ka bërë shumë pak aktivitete fizike. Mesatarisht 30% kanë qenë të ëngazhuara më pak se 20 minuta joaktive. Si përfundim, disa vajza kanë qenë të përfshira në aktivitete fizike mjaftueshëm dhe e kanë përmbushë kriterin sipas udhëzimit numër një, kurse shumica ka qenë e angazhuar

në aktivitete me intensitet të pamjaftueshëm që nuk ka mjaftuar për ta përmbushur udhëzimin numër dy për adoleshente.

Chace M, Vilvens H. -Marrëveshjet e përdorimit të përbashkët (SUA) që lejojnë përdorimin e objekteve shkollore publike nga komuniteti janë rekomanduar si një nga strategjitë kryesore për shëndetin publik dhe për rritjen e aktivitetit fizik. Qëllimi i këtij studimi ishte të shqyrtojë natyrën dhe shtrirjen aktuale të SUA në Ohajo, si dhe përfitimet, pengesat dhe nevojat e perceptuara të administratorëve shkollorë. Përfitimet e perceptuara më së shpeshti përfshijnë përmirësimin e marrëdhënieve me tatimpaguesit. Sipas administratorëve të shkollave, dyert e tyre janë të hapura deri në një farë mase, por shumica e SUA-s ishin marrëveshje joformale. Përpjekjet e avokimit për SUA duhet të përfshijnë kalimin e një ligji të nivelit shtetëror që siguron imunitet të arsyeshëm ndaj përgjegjësisë. Përhapja në komunitetin e shkollës duhet të përfshijë shembuj të marrëveshjeve zyrtare me shkrim, shembuj të menaxhimit të kostos novatore dhe hulumtime të përditësuara mbi lidhjen e aktivitetit fizik me mësimnxënien dhe performancën akademike.

Datalys center for sport Injury research and prevention- Një studim i shkollave të mesme publike zbuloi se 29% e djemve dhe 34% e vajzave janë mbipeshë dhe 16% e djemve dhe vajzave janë të plotë. Në këto shkolla, studentët që morën pjesë në një ose më shumë sporte kishin shumë më pak gjasa të ishin mbipeshë ose të plotë. Një studim i vitit 2012 zbuloi se rreth 29% e studentëve në Hampshir dhe Vermont ishin ose mbipeshë ose të plotë, por nxënësit që merrnin pjesë në një ose më shumë ekipe sportive kishin më pak gjasa të jenë mbipeshë ose të plotë në krahasim me jo pjesëmarrësit. Studiuesit vlerësuan se nëse të gjithë adoleshentët do të luanin në një ose më shumë skuadra sportive në vit, obezitetit do ulje me 26%.

Hasani, M., në punimin e diplomës Master (2012), si qëllim i hulumtimit pa pasur që të hulumtojë se ka janë të orientuar me aktivitete nxënësit apo rinia dhe është bërë krahasimi në mes dy zonave fshat dhe qytet, përkatësisht nxënësit e Gjinnazit Hajdar Dushi të Gjakovës dhe fshatit Ponoshec dhe krahasimin në mes gjinive. Në bazë të rezultateve të fituara autori ka konstatuar se niveli i marrjes me aktivitete fizike i të rinjve nga zona rurale ashtu edhe nga ajo urbane është në nivel tejet të ulët, ku si sjkaktarë për këtë gjendje ka përmendur: mungesën e vetëdijes, të objekteve sportive, organizimit në nivel

institucional, mungesa e shprehisë personale dhe mosnjohja e rëndësisë së rëndësisë së aktivitetit fizik.

Martinez-Gonzales et al., (2001), kanë hulumtuar pjesëmarrjen e të rinjve më të ëvjetër se 15 vjeç nga 15 vende të Unionit evropian. Mostra e tërësishme ka përfshirë 15239 entitete, rreth 100 entitete nga secili vend. Të dhënat i kanë mbledhur përmes intervistave. Është llogaritur harxhimi i energjisë gjatë kohës së lirë në bazë të frekuencës dhe sasisë së kohës së kaluar në aktivitetin e caktuar dhe për secilin aktivitet është dhënë ekuivalenti metabolik MET. Në bazë të rezultateve të fituara, përfaqësuesit e vendeve të Evropës Veriore marrin pjesë më shumë në aktivitete fizike sesa banorët e vendeve të Evropës Jugore. Pjesëmarrjen më të lartë e kanë finlandezët (91.9%), kurse portugezët me 40% e kanë pjesëmarrjen më të ulët. Poashtu është dëshmuar se në aktivitete fizike më shumë marrin pjesë repondentët me nivel më të lartë të arsimimit. Si përfundim kanë treguar se niveli i aktivitetit fizik në Unionin evropian nuk dallohet shumë nga ai i Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Nihiser AJ, Lee SM, Wechsler H, McKenna M, Odom E, Reinold C, Thompson D, Grummer-Strawn L-Një panel ekspertësh, i thirrur nga Qendra për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve (CDC) në vitin 2005 që përbëhej nga ekspertë të shëndetësisë publike, arsimin, këshillimit shkollor, kujdesit shëndetësor dhe një organizatë e prindërve. Kanë bërë një artikull ku përshkruan qëllimet e programeve të matjes së BMI-së, shqyrton praktikën e tanishme, shqyrton kërkimet ekzistuese, përmbledh rekomandimet e ekspertëve, identifikon shqetësimet dhe siguron udhëzime duke përfshirë një listë të masave mbrojtëse dhe ide për hulumtime të ardhshme. Rezultatet e dala nga ky artikull ishte që zbatimi i matjes së BMI-së me bazë në shkollë për qëllime vëzhgimi, domethënë për të identifikuar përqindjen e nxënësve në një popullatë që është në rrezik për probleme të peshës pranohet gjerësisht mbi matjen e BMI-së për qëllime të shqyrtimit, domethënë, për të vlerësuar gjendjen e peshës së nxënësve dhe për t'i dhënë informacione dhe udhëzime prindërve për veprim.

Sirad, J.R., & Pate, R.R. (2001), vlerësimi i aktivitetit fizik te fëmijët dhe adoleshentët. Në këtë punim janë mbledhur 59 artikuj nga revistat ku përmenden përparësitë dhe dobësitë e metodave për evaluimin e aktivitetit fizik te fëmijët dhe adoleshentët. Duke u bazuar në definicionin e aktivitetit fizik si çdo lëvizje të trupit e cila harxhon energji, observimet direkte duhet të merren si standard i artë për hulumtimin e aktivitetit fizik.

Përveç kësaj, mund të përdoret edhe metoda indirekte e akcelerometrisë. Aparatet siç janë monitorët për matjen e frekuencës së zemrës, pedometrat dhe akcelerometrat janë bërë vegla shumë të popullarizuara për matjen e aktivitetit fizik. Këto pajisje e zvogëlojnë subjektivitetin e metodave të vrojtimit dhe mund të përdoren në grupe të mëdha të individëve. Monitorët e punës së zemrës mund të përdoren për formimin e kategorive aktive siç janë: shumë aktive, deri diku aktive dhe sedentare, por iu mungon Specifika e nevojshme për caktimin e aktivitetit fizik të individit. Hulumtimet e ardhshme në fushën e aktiviteteve fizike duhet të rrisin saktësinë e matjeve me kombinimin e 2 e më shumë teknikave. Matjet e sakta të aktivitetit fizik janë kritike për determinimin e nivelit aktual të aktivitetit fizik që do të ishte kompatibil me udhëzimet, të kuptohet doza e relacioneve ndërmjet aktivitetit fizik dhe shëndetit dhe determinimit të efektivitetit të programeve intervenuese të dizajnuara për përmirësimin e aktivitetit fizik.

Telaku, V., (2013), në punimin e diplomës Master, në Mostrën prej 903 nxënës të shkollave të mesme të Malishevës: Gjymnazi “Hamdi Berisha” dhe Shkolla profesionale “Kompetenca” ka pasur për qëllim që të vërtetojë se si e kalojnë kohën e lirë të rinjtë, sidomos nxënësit e shkollave të mesme të profileve të ndryshme të Malishevës. Në bazë të rezultateve të fituara, autori ka konstatuar dallime të rëndësishme statistikore në variablat si e kaloni kohën e lire, ku vajzat e Gjymnazit kohën e lire e kalojnë më së shumti nëpër neja shoqërore, duke dëgjuar muzikë dhe duke lozur me letra, kurse djemtë më së shumti kohë kalojnë pranë kompjuterit dhe pranë televizorit, pastaj duke luajtur shah dhe në plotësimin e fjalëkryqit. Ndërkaq, ndër motivet kryesore që i pengojnë të rinjtë për tu marrë me aktivitete fizike janë mungesa e kohës së mjaftueshme dhe arsye tjera, por pa e specifikuar cilat janë ato.

2 QËLLIMI I PUNIMIT

Qëllim kryesor i këtij punimi Master është prezentimi i nivelit të marrjes me aktivitete rekreativo-sportive, llojet e tyre si dhe kohës më të preferuar për pjesmarrje me këto aktivitete.

Qëllim tjetër është që përmes pyetsorit të njohtohemi për pjesmarrjen aktive në aktivitete rekreativo-sportive, nivelin e konsumit të duhanit, alkoolit si dhe kohën e kaluar për pushim për grupmosha të caktuara dhe për të dyja gjinitë.

Qëllimi i hulumtimit ka rëndësinë teorike dhe praktike.

Qëllimi teorik i hulumtimit është të tregojë se personat të cilët janë të angazhuar në rekreacionin sportiv kanë të zhvilluar ndjenjën e marrjes me aktivitete fizike më tepër sesa ata të cilët nuk janë të përfshirë në sport dhe rekreacionin sportiv si dhe fitojnë shprehi të re të jetesës në drejtim të përmirësimit të shëndetit. Qëllimi praktik i hulumtimit është që në bazë të rezultatit të hulumtimit të inkurajohen më shumë popullatën për angazhim më të madh në aktivitetet rekreative – sportive me qëllim të vetdijësimit të tyre për një shëndet më të mirë.

3 HIPOTEZAT THEMELORE

Në bazë të lëmisë së hulumtimit dhe në përputhje me qëllimin dhe metodat e aplikuara për përpunimin e rezultateve parashtrihen këto hipoteza:

H₀₁ – Presim se do të ketë ndryshime të rëndësishme statistikore në mes gjinive të trajtuara në punim në kuptimin e pjesmarrjes aktive në aktivitete rekreativo-sportive.

H₀₂ – Presim se do të ketë ndryshime të rëndësishme statistikore në mes grupmoshave të trajtuara në punim në kuptimin e pjesmarrjes aktive në aktivitete rekreativo-sportive.

4 METODAT E PUNËS

Ky studim i takon kategorisë së hulumtimeve empirike, ndërsa sipas qëllimit të ndërmarr paraqet hulumtim aplikativ i cila ka për qëllim të fitoj njohuri dhe informacioneve të reja të nevojshme për nivelin e pjesmarrjes me aktivitete rekreative si dhe shprehite individuale tek rinia e komunës së Podujevës.

Duke marrë këtë parasysh, është e nevojshme të kuptojmë dhe të përdorim disa metoda matematikore dhe statistikore në këtë studim, ku do të përzgjidhen ata për të cilat supozohet se do të ndihmojnë në nxjerrjen e konkluzioneve rreth natyrës së problemit të parashtruar.

Në lidhje me njohjen e problemit, ky studim paraqet hulumtim konfirmativ ku në bazë të një problemi të njohur kryhet kontrolli i hipotezave të parashtruara duke përdorur metoda të përshtatshme kërkimore.

Në kushtet e përcaktimit kohor, studimi është i karakterit transfersal, dhe konsiston në një matje të vetme të treguesve përkatës të karakteristikave morfologjike, të cilët janë aktiv në sporte përkatëse.

Në lidhje me shkallën e kontrollit, ky hulumtim shkencor i përket ose bien në kategorinë e hulumtimit shkencore në teren që do të kryhet ose realizohet në kushte natyrore të jetës.

4.1 MOSTRA E ENTITETEVE

Popullata e trajtuar në këtë punim përbëhet nga nxënësit e shkollës së mesme të lartë “Fan S. Noli” në komunën e Podujevës.

Mostra e të anketuarve përfshin 200 nxënës të rastësishëm të kësaj treve të të dyja gjinive, domethënë, nga 100 të anketuar për të dy gjinitë. Mostra e të anketuarve është ndarë sipas këtyre kategorive dhe në dy nëngrupe.

Grupin e parë e përbëjnë mostra e moshës 15-16 vjeçare ku 50 të anketuar janë të gjinisë mashkullore dhe 50 të tjerë të gjinisë femrore.

Grupin e dytë e përbëjnë mostra e moshës 17-18 vjeçare ku 50 të anketuar janë të gjinisë mashkullore dhe 50 të tjerë të gjinisë femrore.

4.2 MOSTRA E VARIABLAVE

Si variabla të mundshme për hulumtim kemi përfshirë pyetjet e përmbledhura në pyetësor posaçërisht i konstruktuar për këtë hulumtim. Në pjesën ku ka të bëjë në vlerësimin e shprehive të jetesës të anketuarave si indikator ose tregues kryesor janë të dhëna përshkrimet aktiviteteve të mëposhtme të cilat konsiderohen si shprehi të jetesës: Pirja e cigareve, konsumimi i alkoolit, ushqimi i rregullt, gjumi i rregullt dhe marrja me aktivitete rekreative - sportive.

4.2.1 Variablat e aplikuara

I-Merreni me aktivitet rekrative sportive.

1. Po i\e rregullt (se paku 3 here ne jave)
2. Kohe pase kohe (kryesisht vikendeve)

3. Asnjehere

II- A jeni te informuare per ndikimin e aktiviteteve fizike ne shendet ?

1. Po
2. Jo
3. Mesatarisht
4. Mjaftushem

III-Organizimi i aktivitetit sportive dhe rekrative sportive ne Podujeve do te jete i dobisheme.

1. PO
2. Nuk jame i sigurte
3. Jo

IV- A do deshironi te humbni peshe dhe te mirëbani formen trupore ?

1. Po
2. Jo
3. Nuk kam pergjigje

V-Organizimi i aktiviteteve sportive rekrative a eshte i mjaftusheme ne shkollen tuaj?

1. Nuk jame i sigurt
2. Po
3. Jo
4. Mjaftushem

VI-Me cilin sport do merreshit nese do të kishit mundesi?

1. SPorte garuese
2. SPorte rekreative
3. Fitnes dhe aerobi

VII-Frekuenca e konsumimit te cigareve, sa është konsumimi ditorë?

1. Deri 5-10 cigare.
2. Deri 10-20 cigare.
3. Ma teper se 20 cigare ne dite.
4. Nuk e konsumoje.

VIII- Konsumimi i alkoholit.

1. Regullisht (çdo dite)
2. Kohe pas kohe (nganjhere ne jave)
3. Nuk e konsumoj

IX- Sa ore gjume beni?

1. 4-5 ore
2. 6-7 ore
3. 7-8 ore
4. më shumë se 8 orë

5 METODAT PËR PËRPUNIMIN E TË DHËNAVE

Në mënyrë që kërkimi shkencor që të ketë kuptimin dhe rëndësinë shkencore, është e nevojshme që të përdoren procedurat e duhura, të drejta dhe komparative e që janë të natyrës së atij problemi të dhënë.

Duke marrë parasysh të gjitha këto fakte, për qëllimet e këtij hulumtimi janë zgjedhë procedurat për të cilat konsiderohet se korrespondojnë me natyrën e problemeve që do të hulumtohen.

Për çdo variabël antropometrike, janë llogaritur vlerat e mëposhtme:

1. Parametrat qëndrore themelor dhe të shpërndarjes:

- Mesatarja aritmetikore (Ma),
- Devijimi standard (Ds),
- Vlera minimale (Min),
- Vlera maksimale (Max).

2. Nga hapësirat e statistikës komparative (krahasuese) për dy grupe të mostrave të pavarura do të përdoret procedura diskriminative, para se gjithash, analiza parashikuese (t - testi) e cila aplikohet për të shqyrtuar dallimin në mes të grupmoshave të ndryshme dhe të të dyja gjinitë.

6 REZULTATET DHE DISKUTIMI

6.1 Frekuencat dhe përqindjet e përgjigjeve të femrave 15-16 vjeçare

Në këtë punim nga parametrat themelorë statistikorë janë llogaritur frekuencat, përqindjet dhe përqindjet kumulative për të paraqitur shpërndarjen e rezultateve të përgjigjeve të respondentëve në pyetjet rreth opinioneve të nxënësve lidhur me aktivitetet fizike dhe shprehjet e jetës së të rinjve.

Tabela 1 A merreni me aktivitete rekreative sportive^a				
	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Po i rregullt	15	30.0	30.0	30.0
Kohë pas kohe	31	62.0	62.0	92.0
Asnjëherë	4	8.0	8.0	100.0
Total	50	100.0	100.0	

a. GJINIA = 15-16 FEMRAT

Në pyetjen a merreni me aktivitete fizike (tabela 1), 15 veta Spo 30% janë përgjigjur që merren rregullisht, 31 apo 62% merren me aktivitete rekreative sportive kohë pas kohe, kurse 4 veta apo 8% asnjëherë nuk janë fizikisht aktive.




Figura 1 Marrja me aktivitete rekreative sportive

Tabela 2 A jeni te informuar për ndikimin e aktiviteteve fizike në shëndet ?^a					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
	Po	32	64.0	64.0	64.0
	Jo	6	12.0	12.0	76.0
	Mesatarisht	12	24.0	24.0	100.0
	Total	50	100.0	100.0	
a. GJINIA = 15-16 FEMRAT					

Tridhjetë e dy veta apo 64 % e vajzave (tabela 2) kanë informata lidhur me ndikimin e aktiviteteve fizike në shëndet, 6 veta apo 12% nuk janë të informuara, kurse njohuri mesatare kanë 12 apo 24% të vajzave të moshës 15-16 vjeçare.




Figura 2 informimi i adoleshentëve për ndikimin e saktivitetit fizik në shëndet

Tabela 3 Organizimi i aktiviteteve sportive dhe rekreative sportive në Podujevë do të jetë i dobishëm					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
	Po	34	68.0	68.0	68.0
	Nuk jam i sigurtë	14	28.0	28.0	96.0
	Jo	2	4.0	4.0	100.0
	Total	50	100.0	100.0	
a. GJINIA = 15-16 FEMRAT					

Lidhur me dobinë e aktiviteteve fizike në Podujevë (tabela 3) 34 veta apo 68% besojnë se do të ishin të dobishme, 14 apo 28% nuk janë të sigurt kurse 2 veta apo 4% mendojnë se nuk do të jetë i dobishëm organizimi i aktiviteteve sportive dhe rekreative në Podujevë.

Tabela 4 A do të dëshironi të humbni peshë dhe të mirëmbani formën trupore?					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
	Po	39	78.0	78.0	78.0
	Jo	8	16.0	16.0	94.0
	Nuk kam përgjigje	3	6.0	6.0	100.0
	Total	50	100.0	100.0	

a. GJINIA = 15-16 FEMRAT




Figura 3 Mirëmbajtja e formës së trupit

Shumica e respondentëve (tabela 4), 39 sish apo 78% pajtohen se kanë dëshirë të humbin në peshë dhe të mirëmbajnë formën trupore, 8 veta apo 16% nuk pajtohen, kurse 3 veta apo 6% nuk kanë përgjigje për këtë problematikë.

Tabela 5 Organizimi i aktiviteteve sportive rekreative a është i mjaftueshëm në shkollën tuaj?					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Nuk jam i sigurtë	5	10.0	10.0	10.0
	Po	12	24.0	24.0	34.0
	Jo	25	50.0	50.0	84.0
	Mjaftueshëm	8	16.0	16.0	100.0
	Total	50	100.0	100.0	
a. GJINIA = 15-16 FEMRAT					

Lidhur me mjaftueshmërinë e aktiviteteve sportive rekreative që organizohen në shkollën e tyre (tabela 5) 5 reSpondente apo 10% e tyre nuk janë të sigurta, 12 apo 24% mendojnë që po, kurse shumica e tyre (25 veta apo 50%) nuk pajtohen se ka aktivitete të mjaftueshme në shkollë, kurse vetëm 8 veta apo 26% pajtohen se ka mjaftueshëm aktivitete sportive rekreative brenda shkollës së tyre.

Tabela 6 Me cilin sport do të merreshit nëse do të kishit mundësi?					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	sport garues	27	54.0	54.0	54.0
	sport rekreativ	6	12.0	12.0	66.0
	Fitnes dhe aeroabi	17	34.0	34.0	100.0
	Total	50	100.0	100.0	
a. GJINIA = 15-16 FEMRAT					




Figura 4 Marrja me sport

Shumica e vajzave, 27 sish apo 54% do të donin të merreshin me ndonjë sport garues (tabela 6), vetëm 6 prej tyre apo 12% do të donin të merreshin me sport rekreativ, kurse 17 veta apo 34% do të praktikonin fitness dhe aerobi.

Tabela 7 Sa cigare konsumoni në ditë?^a

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	10-20	4	8.0	8.0	8.0
	Nuk Konsumoj	46	92.0	92.0	100.0
	Total	50	100.0	100.0	

a. GJINIA = 15-16 FEMRAT




Figura 5 Konsumimi i duhanit

Sa i përket konsumimit të duhanit (tabela 7) pjesa dërrmuese e vajzave të kësaj grupmoshe 46 sish apo 92% nuk konsumojnë duhan, kurse vetëm 4 veta apo 8% konsumojnë 10 deri 20 cigare në ditë.

Tabela 8 A konsumoni pije alkoolike^a					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Kohë pas kohe	1	2.0	2.0	2.0
	Nuk e konsumoj	49	98.0	98.0	100.0
	Total	50	100.0	100.0	

a. GJINIA = 15-16 FEMRAT




Figura 6 Konsumimi i alkoolit

Situata është edhe më e mirë edhe sa i përket konsumimit të pijeve alkoolike (tabela 9), pasi vetëm një reSpondent është deklaruar se është konsumuese e alkoolit, kurse 98% e vajzave tjera nuk konsumojnë alkool fare, që është një tregues i shëndetit të mirë dhe i pranishëm së një vetëdije të lartë lidhur me pasojat e dukurive dhe shprehive negative në shëndet. Ndoshta në këtë mund të ketë ndikuar fakti se tradicionalisht në këtë trevë më pak konsumohen pijet alkoolike e më shumë pijet freskuese si çaji dhe kafja.

Tabela 9 Sa orë gjumë në ditë i bëni ?^a					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative
Valid	4-5 orë	6	12.0	12.0	12.0
	6-7 orë	11	22.0	22.0	34.0
	7-8 orë	20	40.0	40.0	74.0
	Mbi 8 orë	13	26.0	26.0	100.0
	Total	50	100.0	100.0	

a. GJINIA = 15-16 FEMRAT

Në pyetjen sa orë në ditë i bëni gjumë (tabela 9), repondentët kanë dhënë përgjigje të shpërndara. Gjashtë prej tyre apo 12% flejnë vetëm 4-5 orë në ditë që është larg nën normën e kërkuar, 11 veta apo 22% bëjnë 6-7 orë gjumë në ditë, 20 veta apo 40% flejnë 7-8 orë në ditë, kurse 13 veta apo 26% bëjnë mbi tetë orë gjumë në ditë.

6.2 Frekuencat dhe përqindjet e përgjigjeve të femrave 17-18 vjeçare

Tabela 10 A merreni me aktivitete rekreative sportive ^a					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Po i rregullt	10	20.0	20.0	20.0
	Kohë pas kohe	34	68.0	68.0	88.0
	Asnjëherë	6	12.0	12.0	100.0
	Total	50	100.0	100.0	
a. GJINIA = 17-18 FEMRAT					




Figura 7 Marrja me aktivite rekrative sportive

Vetëm 10 veta apo 20% e vajzave të moshës 17-18 vjeçare merren rregullisht me aktivite rekrative sportive (tabela 10), 34 veta apo 68% vetëm Kohë pas kohe janë fizikisht active, kurse 6 veta apo 12% nuk praktikojnë kurrëfar aktiviteti rekrativo sportive.

Tabela 11 A jeni te informuar për ndikimin e aktiviteve fizike në shëndet ?^a

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Po	34	68.0	68.0	68.0
	Jo	4	8.0	8.0	76.0
	Mesatarisht	12	24.0	24.0	100.0
	Total	50	100.0	100.0	

a. GJINIA = 17-18 FEMRAT




Figura 8 Informimi rreth ndikimit të aktiviteteve fizik në shëndet

Pjesa dërrmuese e respondentëve 34 sish apo 68% janë të informuara lidhur me ndikimin e aktiviteteve fizike në shëndetin e tyre (tabela 11), 4 veta apo 8% nuk kanë informata të tilla, kurse 12 veta apo 24% janë mesatarisht të informuar.

Tabela 12 Organizimi i aktiviteteve sportive dhe rekreative sportive në Podujevë do të jetë i dobishëm^a

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Po	33	66.0	66.0	66.0
	Nuk jam i sigurtë	15	30.0	30.0	96.0
	Jo	2	4.0	4.0	100.0
	Total	50	100.0	100.0	

a. GJINIA = 17-18 FEMRAT

Lidhur me dobinë e organizimit të aktiviteteve fizike në Podujevë (tabela 12) 33 veta apo 66% besojnë se do të ishin të dobishme, 15 apo 30% nuk janë të sigurt, kurse 2 veta apo

4% mendojnë se nuk do të jetë i dobishëm organizimi i aktiviteteve sportive dhe rekreative në Podujevë.

Tabela 13 A do të dëshironi të humbni peshë dhe të mirëmbani formën trupore ?^a					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Po	33	66.0	66.0	66.0
	Jo	10	20.0	20.0	86.0
	Nuk kam përgjigje	7	14.0	14.0	100.0
	Total	50	100.0	100.0	

a. GJINIA = 17-18 FEMRAT




Figura 9 mirëmbajtja e formës trupore

Shumica e respondentëve (33 veta apo 66%) të moshës 17-18 vjeçare do të dëshironin të humbin peshë dhe të mirëmbanin formën trupore (tabela 13), 10 veta apo 20% nuk duan të humbin peshë, kurse 7 veta apo 14% kanë ndonjë përgjigje.

Tabela 14 Organizimi i aktiviteteve sportive rekreative a është i mjaftueshëm në shkollën tuaj?^a					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Nuk jam i sigurtë	12	24.0	24.0	24.0
	Po	12	24.0	24.0	48.0
	Jo	20	40.0	40.0	88.0
	Mjaftueshëm	6	12.0	12.0	100.0
	Total	50	100.0	100.0	
a. GJINIA = 17-18 FEMRAT					

Përgjigjet janë të shpërndara sa i përket pyetjes se a janë të mjaftueshme aktivitetet sportive rekreative që organizohen në shkollën tuaj (tabela 14). Kështu 12 femra apo 24% nuk janë të sigurta në përgjigjet e tyre, po aq sa është edhe numri i atyre që mendojnë se aktivitetet në shkollë janë të mjaftueshme, kurse 20 veta apo 40% nuk pajtohen me pohimin.

Tabela 15 Me cilin sport do të merreshit nëse do të kishit mundësi?^a					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	sport garues	16	32.0	32.0	32.0
	sport rekreativ	8	16.0	16.0	48.0
	Fitnes dhe aeroabi	26	52.0	52.0	100.0
	Total	50	100.0	100.0	

a. GJINIA = 17-18 FEMRAT




Figura 10 Marrja me sport

Sa i përket sportit me të cilin do të merreshin (tabela 15) vajzat e grup-moshës 17-18 vjeçare janë më shumë të interesuara për fitness dhe aeroabi (52% e tyre), 16 vet apo 32% do ta zgjedhnin sportin garues, kurse 8 veta apo 16% sportin rekreativ.

Tabela 16 Sa cigare konsumoni në ditë? ^a					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	5-10 cigare	5	10.0	10.0	10.0
	Mbi 20 cigare	4	8.0	8.0	18.0
	Nuk konsumoj	41	82.0	82.0	100.0
	Total	50	100.0	100.0	

a. GJINIA = 17-18 FEMRAT




Figura 11 Konsumimi i duhanit

Lidhur me shprehinë e peirjes së duhanit(tabela 16), pjesa dërrmuese e respondentëve (41 apo 82%) nuk konsumojnë duhan fare, 5 veta apo 10% konsumojnë deri 10 cigare në ditë, kurse 4 veta apo 8% konsumojnë mbi 20 cigare në ditë.

Tabela 17 A konsumoni pije alkoolike ^a					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Kohë pas kohe	2	4.0	4.0	4.0
	Nuk e konsumoj	48	96.0	96.0	100.0
	Total	50	100.0	100.0	

a. GJINIA = 17-18 FEMRAT




Figura 12 Konsumimi i alkoolit

Sikur vajzat më të reja të grup-moshës 15-16 vjeçare, edhe ato dy vjet më të moshuara pothuaj fare (96%) nuk e konsumojnë alkoolin (tabela 17) që është një dëshmi për një rini të shëndoshë. Vetëm 2 veta janë deklaruar se konsumojnë pije alkoolike që është një shifër e papërfillshme.

Tabela 18 Sa orë gjumë në ditë i bëni ? ^a					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	4-5 orë	9	18.0	18.0	18.0
	6-7 orë	12	24.0	24.0	42.0
	7-8 orë	15	30.0	30.0	72.0
	Mbi 8 orë	14	28.0	28.0	100.0
	Total	50	100.0	100.0	
a. GJINIA = 17-18 FEMRAT					

